



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2019

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

MBI PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.55/2015, “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11/12/2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Arben Ahmetaj.

Për të prezantuar projektligjin ishte i pranishëm Z. Ilir Beqaj në cilësinë e propozuesit.

Gjithashtu si përfaqësues të Qeverisë ishin të pranishëm Znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të lartë të kësaj ministrie.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozim i një deputet në mbështetje në neneve 81 pika 1, të Kushtetutës dhe është hartuar në përputhje me nenin 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Projektligji bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji parashikon ndryshimin e nenit 36, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, duke shtyrë afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” deri më 31 dhjetor 2020.

IV. Efektet financiare

Projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji, propozon një ndryshim në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ligj i cili ka në fokus nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorë strategjikë, si ai energjetik dhe minerar; transportit, infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe mbetjeve urbane; turizmit; bujqësisë dhe peshkimit, zonave të teknologjisë e zhvillimit ekonomik si dhe zonave me përparësi zhvillimi. Nëpërmjet këtij ligji, janë vendosur procedura të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptuese me qëllim mbështetjen e shërbimeve ndaj investitorëve. Dua të vë theksin në faktin se ishte pikërisht ky ligj, i vitin 2015, i cili bazuar në parimin e transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit, mundësoi përmes një kuadri të plotë ligjor mbrojtje të njëjtë si për investimet e huaja ashtu edhe për investimet vendase, të cilat më parë nuk ishin të mbrojtura.

Ndryshimi i propozuar përmes këtij projektligji, ka për qëllim, zgjatjen e afatit për paraqitjen e kërkesave, nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”. Ky afat është deri më 31 dhjetor 2019 dhe propozohet të zgjatet deri më 31 dhjetor 2020. Zgjatja e këtij afati ka për qëllim mundësimin e përfitimit nga lehtësirat që ofron ligji nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” edhe për 1 vit tjetër, për të gjithë investitorët vendas apo të huaj.

Deputeti propozues shpjegoi se zgjatja e afatit ka për qëllim mundësimin e përfitimit nga lehtësirat që ofron ligji nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” edhe për 1 vit tjetër, për të gjithë investitorët vendas apo të huaj.

Gjithashtu ai shpjegoi se Ministria e Financave dhe Ekonomisë aktualisht është duke punuar për hartimin e një projektligji të ri “Për investimet”, por meqenëse ky projektligj akoma nuk

ka shkuar për miratim në Këshillin e Ministrave, për rrjedhojë nuk ka mundësi reale që të shqyrtohet e miratohet nga Kuvendi deri me 31 dhjetor 2019, datë kjo kur përfundon edhe afati i ligjit ekzistues. Kësisoj rrezikohet krijimi i një boshllëku ligjor dhe pikërisht për të shmangur këtë boshllëk propozohet edhe shtyrja e afatit të këtij ligji edhe me një vit tjetër.

Gjatë këtij afati 1 vjeçar që propozohet të shtyhet, sigurohet edhe koha e nevojshme për Qeverinë për përfundimin e iniciativës dhe për shqyrtimin e miratimin e mëtejshëm në Kuvend të nismës së re për investimet.

Përfaqësuesit e Ministrisë së financave dhe Ekonomisë dakortësuan propozimin për shtyrjen edhe me 1 vit të këtij afati.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Komiteti i Investimeve Strategjike si dhe të gjitha institucionet dhe organet e administratës shtetërore që kanë në fushën e kompetencave të tyre elementë specifik procedural.

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se përmes këtij projektligji i jepet një mundësi e shtuar investitorëve vendas dhe të huaj për të investuar në sektorë strategjikë, me votat pro të shumicës së gjithë anëtarëve të pranishmëve e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

KRYETAR

Arben AHMETAJ